REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**
**SENATI AKADEMIK**

Nr.689/18 prot. Elbasan, më 17.03.2025

**VENDIM**

**Nr.46, datë 17. 03.2025**

**"PËR HAPJEN E PROCESIT TË KANDIDIMIT PËR ANËTAR TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME NË NIVEL INSTITUCIONAL NË UNIVERSITETIN E ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Statutit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", neni 9/p dhe 24/3, Senati Akademik,

**VENDOSI:**

1. Të shpallë hapjen e procesit të kandidimit për anëtar të Komisioneve të Përhershme në nivel institucional në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" si më poshtë:
   a) Komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit, i cili përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, nga të cilët 6 (gjashtë) janë anëtarë nga personeli akademik i UE-së që i përkasin kategorisë "Profesor" ose/dhe "Lektor" dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve.
   b) Komisioni për marrëdhëniet me studentët dhe këshillimin e karrierës, i cili përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, nga të cilët, 6 (gjashtë) janë anëtarë nga personeli akademik i UE-së që i përkasin kategorisë "Profesor" ose/dhe "Lektor" dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve.
2. Anëtarët e këtyre komisioneve, që i përkasin personelit akademik, vetëndidohen dhe janë anëtarë përfaqësues të fakulteteve,
3. Anëtarët studentë vetëndidohen dhe janë anëtarë përfaqësues të studentëve të UE-së.
4. Regjistrimi i kandidatëve fillon më datë 18.03.2025 dhe përfundon më datë 28.03.2025.

Adresa: Rruga "Ismail Zyma", Elbasan, Tel. +355 54 252593, www.uniel.edu.al, info@uniel.edu.al

5. Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë sekretarisë së Senatit Akademik dokumentacionine mëposhtëm:
   - Kërkesën për vetëkandidim.
   - Kopje të dokumnetit të identifikimit.
   - Kopje të titullit akademik ose gradës shkencore (për kandidatin nga personeli akademik).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të UE-së.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**Prof.Dr. Elvira Fetahu**